



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 25 regjistër (JR)
Datë 03.07.2024

Nr. 42 i vendimit
Datë 20.05.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e martë, më datë 20.05.2025, në orën 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me sekretare gjyqësore Anisa Sejdi, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 25/2024 (JR), datë 03.07.2024, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 760, datë 26.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2 dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionit Publik të paraqitura në ankim, si dhe parashtrimet dhe konkluzionet

përfundimtare të paraqitura nga përfaqësuesi me autorizim i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 760, datë 26.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokaten e saj Romina Zano, që kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë në tërësi,

VËREN SE:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ardiana Bera (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja, në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, i deklasifikuar plotësisht, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

2.3. KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore publike, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Ardiana Bera:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;

c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

4. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni, me vendimin nr. 760, datë 26.04.2024, ka vendosur: *“Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ardiana Bera, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.*

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

5. Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 760, datë 26.04.2024, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji që në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e tij, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 dhe nenin 66, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016, të vendosë ndryshimin e vendimit objekt ankimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera.
6. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 760, datë 26.04.2024, të Komisionit, çmon se ai është i cënueshëm dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
7. Referuar përmbajtjes së ankimit të Komisionerit Publik, çështjet e ngritura prej tij paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - *Për pasurinë apartament, me sipërfaqe totale 136,7 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*
8. Komisioneri Publik, në kushtet kur: (i) nuk u provua mbulimi me burime të ligjshme i huasë në shumën 2.000.000 lekë nga personat e tjerë të lidhur; dhe (ii) nuk u provua krijimi me burime të ligjshme i kursimeve *cash* të deklaruar si burim krijimi për këstet e paguara për blerjen e pasurisë “Apartament me sipërfaqe totale 136,7 m²“, në vitin 2004, vlerëson se këto rrethana që lidhen me burimet e deklaruar, afektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme këstet e blerjes së kësaj pasurie.
9. Lidhur me pagesën e këstit të fundit, në shumën 10.000 USD, në vitin 2005, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për vitin 2005, në vlerën (-) 715.068 lekë. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për përfshirjen në analizën financiare të vitit 2005 të shumës prej 600.000 lekësh, të kthyer nga shoqëria ndërtuese, bie ndesh me aktet e administruara në dosje dhe nuk duhet konsideruar në analizën financiare të vitit 2005.
10. Në përfundim, për këtë pasuri, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme pagesat e kryera për blerjen e pasurisë “Apartament me sipërfaqe 136,7 m²”, si dhe kursimet *cash* të deklaruar si burim krijimi për këto pagesa, duke

u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

- *Për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë në datën 15.02.2007*

11. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me burimet e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, pasi në deklaratën periodike të vitit 2007 nuk deklaroi burim krijimi, ndërsa në deklaratën *vetting* deklaroi si një nga burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf”, që rezulton të jetë shitur disa muaj më vonë.
12. Sa i takon mbulimit me burime të ligjshme të depozitës në shumën 9.000 euro, që deklarohet si burim krijimi për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, në të gjitha variantet e analizës financiare të administruara në dosje, përfshirë dhe atë të depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, ka rezultuar mungesë e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj depozite. Komisioneri Publik vëren që, dhe në analizën financiare të depozituar nga subjekti, ku përfshihen likuiditetet *cash* në fillim dhe në fund të vitit 2006, si dhe huaja e deklaruar e shlyer në shumën 1.000.000 lekë, ka rezultuar një diferencë negative në vlerën (-) 266.117 lekë. Nëse në këtë analizë do të përfshihej edhe shuma 9.000 euro, që subjekti e ka deklaruar si kursim *cash* në deklaratën periodike të vitit 2006, por gjatë hetimit ka deklaruar se këtë shumë nuk e ka disponuar *cash*, por në llogari bankare, atëherë diferenca negative do të ishte ndjeshëm më e lartë. Komisioneri Publik thekson dhe faktin që kursimet *cash* të deklaruar nga subjekti në deklaratën e parë të pasurisë dhe që mbarten në vitet pasuese kanë rezultuar se nuk mbulohen plotësisht me burime të ligjshme.
13. Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat e mësipërme, lidhur me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa {***}, blerë në datën 15.02.2007, duhen marrë në konsideratë nga Kolegji, në një vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, duke iu shtuar diferencave negative të trajtuara në vlerësimin tërësor të këtij kriteri.

- *Për llogarinë “Futura” në lekë, në emër të vajzës së subjektit në Intesa Sanpaolo Bank*

14. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, lidhur me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2007, Komisioneri Publik vëren se, edhe duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se si burim krijimi kanë shërbyer kursimet *cash* të disponuara në fillim të vitit, të cilat më pas janë zëvendësuar përsëri me të ardhurat e vitit respektiv, nga analiza vjetore e Komisionit, ka rezultuar se pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2007 nuk mbulohen plotësisht me burime të ligjshme. Sa i takon pamjaftueshmërisë së konstatuar për vitin 2007, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 nuk janë llogaritur sipas standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit, llogaritja e të cilave, sipas këtij standardi, e çon pamjaftueshmërinë e vitit 2007 në vlerën negative (-) 716.209 lekë.
15. Sipas Komisionerit Publik, subjekti nuk mbulon plotësisht me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e krijuara në vitin 2007, përfshirë këtu dhe krijimin e llogarisë

“Futura”, në lekë, në emër të vajzës. Konstatohet, po ashtu, se për krijimin e llogarisë në emër të vajzës në vitin 2007 janë deklaruar si burim shumëat e dhëna nga vëllezërit në formë huaje/dhurimi, për të cilat nuk është provuar ligjshmëria e burimit të krijimit.

16. Komisioneri Publik vlerëson se arsyetimi i Komisionit në vendim se: *mungesa e likuiditeteve nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për vitin 2005 në vlerën (-) 115.068 lekë, për vitin 2006 në vlerën (-) 112.709 lekë dhe për vitin 2007 në vlerën (-) 337.489 lekë, për gjithë periudhën e deklarimit nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit*, nuk qëndron, pasi dhe vetë rezultati financiar negativ i konstatuar nga Komisioni për vitet 2003, 2005, 2006 dhe 2007, në vlerën rreth (-) 2.200.000 lekë, tejkalon dhe nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji në raste të ngjashme.
17. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3, i lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
18. Komisioneri Publik vëren se gjatë procedurave të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisioni çmoi dhe bëri pjesë të hetimit administrativ, duke ia përcjellë gjetjet përkatëse në aktin “Rezultate të hetimit” edhe vendimin nr. {***}, datë 07.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtares të trupit gjykues. Pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura me shkrim nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në arsyetimin e vendimit, ka parashtruar qëndrimin se, duke qenë se jemi në kushtet e një çështjeje që është në gjykim, si e tillë ajo nuk mund të përfshihet në vlerësimin e aftësive profesionale. Komisioneri Publik, përkundër sa arsyeton Komisioni, bazuar në argumentet që janë përdorur prej tij (Komisionit), nga burimet e hapura të informacionit konstaton se vendimi i referuar, marrë nga GjEDNj-ja, edhe pse lidhet me të njëjtën ngjarje, ka të bëjë me një procedim të pezulluar e të ndarë, të ndryshëm nga ai që është objekt i gjykimit të konkluduar me vendimin nr. {***}, datë 07.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas Komisionerit Publik, në referencë të shpjegimeve të paraqitura me shkrim nga ana e subjektit të rivlerësimit, pas dërgimit të aktit “Rezultate të hetimit” nga ana e Komisionit, ky i fundit do të duhej t’i kishte marrë në vlerësim ato dhe të argumentonte një qëndrim, që lidhet me gjetjet përkatëse, duke çmuar dhe mbajtur në konsideratë njëkohësisht edhe jurisprudencën e Kolegjit¹. Në të tilla rrethana, kjo çështje duhet të gjejë trajtim në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar nga ana e Kolegjit.
19. Në përfundim, Komisioneri Publik kërkon nga Kolegji që, bazuar në nenet Ç, D dhe F të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” të këtij ligji, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 760, datë*

¹ Vendimit të Kolegjit (JR) nr. 9/2020, prg. 16.5 - 16.10.

26.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

20. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

21. Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
22. Komisioneri Publik rezulton se ka marrë njoftim për vendimin e Komisionit në datën 06.06.2024, dhe ankimin e ka paraqitur në datën 14.06.2024. Për rrjedhojë, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, dhe ankuesi legjitimohet *ratione temporis*.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

23. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 09.04.2025, 05.05.2025 dhe 20.05.2025.
24. Trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerit Publik, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore të datës 09.04.2025, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik tek Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

25. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën e datës 09.04.2025, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkë me parashtrimet dhe disa akte shkresore², të cilat ka kërkuar të merren në cilësinë e provës. Trupi gjykues i Kolegjit, në këtë seancë, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të pranojë në cilësinë e provës, nën dritën e nenit F, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, informacionin e sjellë nga shoqëria “{***}” ShPK dhe aktet bashkëlidhur tij. Trupi gjykues vendosi të mos pranojë aktet që janë sjellë nga subjekti për të dëshmuar të ardhurat e vëllait të saj në Mbretërinë e Bashkuar, për shkak të mungesës së formës së duhur ligjore.
26. Subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të datës 09.04.2025, paraqiti shpjegimet lidhur me denoncimet e ardhura në adresë të Kolegjit, shoqëruar dhe me aktet përkatëse. Trupi gjykues, pasi u njoh me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me denoncimet e administruara për të në Kolegj, analizoi dhe shqyrtoi shpjegimet e dhëna dhe aktet e paraqitura në mbështetje të tyre, duke marrë në konsideratë edhe qëndrimin e shprehur të përfaqësuesit të autorizuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se denoncimet nuk përmbajnë shkaqe për hetime të mëtejshme, vlerësoi se informacioni i përcjellë nëpërmjet tyre nuk plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, vendosi të mos vijojë me hetimin e mëtejshëm të tyre.
27. Subjekti i rivlerësimit, në datën 29.04.2025, i është drejtuar Kolegjit me një kërkesë për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja me qëllim hetimin dhe shqyrtimin e plotë të çështjes. Trupi gjykues, në seancën gjyqësore publike të datës 5.05.2025, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet e reja shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me këtë kërkesë³.
28. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim, qëndrimet e palëve përgjatë procesit gjyqësor, si edhe analizoi e vlerësoi të gjitha provat që gjendeshin në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, dhe që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve, duke arsyetuar e konkluduar si vijon.

² Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa deklarata tatimore për shtetasin M. B., në gjuhën angleze, të përkthyer në gjuhën shqipe, për llogaritjen e taksave për vitin 1996 dhe për vitet 2016 – 2024, si dhe një vërtetim të datës 04.04.2025, i shoqërisë “{***}” ShPK.

³ Subjekti i rivlerësimit bashkë me kërkesën ka paraqitur aktet: 1. Deklaratë noteriale e z. M. B., datë 23.04.2025, përpara noteres britanike D. S., apostiluar më datë 25.05.2024, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e së cilës janë dokumentet si vijojnë; • Të dhënat e punësimit nga {***} për M. B., P45, me PAYE Reference {***}; • Përmbledhje për vitin tatimor 1999/2000, lëshuar nga gov.uk – HRMC, më 14.04.2025 (në gjuhën angleze dhe shqipe); • Shkresë nga “{***}” Ltd, datë 15.04.2025, (në gjuhën angleze dhe shqipe); Dëshmia kombëtare e sigurimeve shoqërore për periudhën 1995-2024, lëshuar elektronikisht nga www.gov.uk. 2. Vërtetim noterial i lëshuar nga notere D. S. më datë 28.04.2025, apostiluar më datë 29.04.2025, për shkarkimin nga web-i dhe njësinë me origjinalin të dokumenteve të mëposhtme: • Përmbledhje për vitin tatimor 1999/2000, lëshuar nga gov.uk- HRMC; • Dëshmia Kombëtare e Sigurimeve Shoqërore për periudhën 1995-2025, nxjerrë elektronikisht nga www.gov.uk. 3. Vërtetim noterial i lëshuar nga notere D. S. më datë 28.04.2025, apostiluar më datë 29.04.2025, për vërtetësinë e të dhënave të përmbajtur në dokumentin bashkëlidhur (fotokopje) Dëshmia e punëmarrësit M. B., lëshuar nga {***}, P45, me PAYE reference {***}, datë 04.12.1996.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik

B 1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

- Për pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 136,7 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë

29. Lidhur me shkaktuesin e ankimit të Komisionerit Publik, sipas së cilit, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 136,7 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme pagesat e kryera për blerjen e pasurisë, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon.
30. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar si më poshtë.

30.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Banesë me sip. totale 136,7 m², e ndodhur në adresën rruga “{***}”, ish Komuna e Parisit, pasuri e krijuar në vitet 2002 deri 2011, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2011. Vlera: 6.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%”. Burimi: “Nga shitja e banesës në qytetin e Krujës me kontratën e shitjes datë 13.09.1999, nr. {***} rep., nr. {***} kol.; nga kursimet familjare në vite të familjes së bashkëshortit; nga të ardhurat dhe shpërblimet nga puna të subjektit deklarues dhe bashkëshortit, nga kursimet familjare, me ndihmën e familjarëve të subjektit (të deklaruara në vite). Bashkëlidhur dokumentacioni, si dhe certifikata për vërtetim pronësie. Tek të dhënat konfidenciale, subjekti ka deklaruar: “[...] Siç kam deklaruar në vitin 2004 (për periudhën kohore 01.01.2003-31.12.2003), unë kisha marrë hua pa kontratë, pa afat dhe pa interes, shumë prej 2.000.000 lekësh tek vëllezërit e mi, M. M. B. (emigrant ekonomik që nga viti 1992, në shtetin anglez, ku vazhdon aktualisht) dhe I. M. B. (në atë kohë emigrant në shtetin anglez për periudhën kohore 1998-2008), për nevojat e blerjes së banesës. [...] Nga kjo hua e marrë, shuma prej 1 milionë lekësh nga ana e familjarëve të mi, prindërve dhe vëllezërve, iu bë dhuratë vajzës time, e cila lindi më 30 janar 2006 (deklaruar ky fakt në deklaratën e datës 16 mars 2007). Nga ana e subjektit dhe bashkëshortit, është shlyer shuma e marrë hua prej 1.000.000 lekësh (deklaruar në deklaratën e datës 16 mars 2007), si rezultat i kursimeve familjare të deklaruara, kursimeve nga pagat, shpërblimet e punës, dhe orë jashtë orarit zyrtar të subjektit dhe bashkëshortit”.*

30.2. Në deklaratën periodike të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Shtëpi banimi, rruga Komuna e Parisit, kullat binjake të firmës “{***}” ShPK Tiranë. Blerë me kontratë sipërmarrjeje, datë 16.03.2002, me sipërmarrës firma “{***}” ShPK, Tiranë. Vlera: 6.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi nga shitja e banesës 3+1 në qytetin e Krujës në shumë 2.000.000 lekë nga të ardhurat nga pagat dhe huamarrje. Për banim jo e paguar gjithë shuma”. Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” në këtë deklaratë është deklaruar: “Detyrim ndaj firmës “{***}” ShPK Tiranë. Vlera: 2.000.000 lekë. Blerje banese me kontratë sipërmarrjeje datë 16.03.2002. [...] M. dhe I. B., refugjatë ekonomikë në Angli. Vlera: 2.000.000 lekë. Për blerjen e banesës me kontratë sipërmarrje datë 16.03.2002”. Në rubrikën “Likuiditete” në këtë deklaratë është deklaruar: “Gjendje cash në*

banesë në shumën 5.000.000 lekë. Burimi: Kursime familjare nga paga ime dhe e bashkëshortit”.

30.3. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Pakësuar gjendja cash gjatë vitit 2004 në banesë, 3.000.000 lekë, mbetur 2 milionë lekë. Për pagesën e detyrimit të shtëpisë”.* Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, në këtë deklaratë është deklaruar: *“Detyrim sipas kontratës së sipërmarrjes për blerje apartamenti në datën 16.03.2002, me vlerë 6 milionë lekë: 1. Në vitin 2003 paguar 2 milionë lekë; 2. Në vitin 2004 paguar 3 milionë lekë nga kursimet cash plus huamarrja nga vëllezërit, e deklaruar në vitin 2003; 3. Mbetur pa paguar 1 milion lekë në momentin e marrjes vërtetimit pronësie”.*

30.4. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Detyrim ndaj kontratës së sipërmarrjes për blerje apartamenti të deklaruar në deklaratën e deklarimit të pasurisë të datës 18.03.2003. Paguar me kursimet nga paga dhe kursimet e mbartura, minus 600.000 lekë. Vlera: 10.000 USD”.*

30.5. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Për pasurinë e paluajtshme banesë apartament deklaruar në 2003 në bazë të kontratës së sipërmarrjes është hartuar kontrata e shitblerjes, datë 23.09.2011, midis palëve shitës shoqëria “{***}” ShPK dhe blerës Ardiana Bera, si dhe regjistruar pasuria”.*

- 31.** Sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., lidhur mes palëve në datën 23.09.2011, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë deklaruar se kanë realizuar shitjen e kësaj pasurie të paluajtshme kundrejt çmimit 6.000.000 lekë, pagesë kjo e kryer sipas mandateve: (i) nr. {***}, datë 16.03.2002, në shumën 14.300 USD; (ii) nr. {***}, datë 22.01.2004, në shumën 2.000.000 lekë; (iii) nr. {***}, datë 15.12.2004, në shumën 1.000.000 lekë; (iv) nr. {***}, datë 23.11.2005, në shumën 10.000 USD.
- 32.** Komisioni, në vendim, lidhur me një nga burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit, huanë prej 2.000.000 lekësh marrë nga vëllezërit, ka konkluduar se: *subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave të vëllezërve të saj (persona të tjerë të lidhur), për dhënien e shumës 2.000.000 lekë në mars të vitit 2002. Informacioni i plotë i shoqëruar me dokumentacion ligjor për burimin e të ardhurave të tyre fillonte pas dhënies së huas. Për sa më sipër arsyetuar, u vlerësua të mos merret në konsideratë si burim krijimi i pasurisë objekt hetimi shuma prej 2.000.000 lekësh, deklaruar hua nga vëllezërit në analizën financiare të përgatitur me rezultatet e hetimit për subjektin.*
- 33.** Për këto arsye, huaja në vlerën 2.000.000 lekë nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në fund të vitit 2003, të deklaruar nga subjekti në vlerën 5.000.000 lekë. Sipas analizës përfundimtare të treguesve financiarë të kryer në Komision për periudhën shtator 1991 – 31 dhjetor 2003, për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë likuiditetin e deklaruar për periudhën shtator 1991 – 31 dhjetor 2003, duke rezultuar me balancë negative

në vlerën (-) 1.669.152 lekë, për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti në fund të vitit 2003.

34. Ndërsa lidhur me pagesën për shoqërinë ndërtuese në vitin 2005, në vlerën 10.000 USD, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për blerje pasurie, shtesën në likuiditet të deklaruar dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2005, duke rezultuar me një balancë negative për këtë vit në vlerën (-) 115.068 lekë. Komisioni, në analizën financiare të vitit 2005, në përfundim ka pranuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për kthimin e vlerës 600.000 lekë nga shoqëria ndërtuese për kryerjen e punimeve shtesë.
35. Komisioneri Publik, në ankim: *“Në kushtet kur: (i) nuk u provua mbulimi me burime të ligjshme i huas në shumën 2.000.000 lekë nga personat e tjerë të lidhur; dhe (ii) nuk u provua krijimi me burime të ligjshme i kursimeve cash të deklaruar si burim krijimi për këstet e paguara për blerjen e pasurisë “Apartament me sipërfaqe totale 136,7 m² , në vitin 2004”, vlerëson se këto rrethana që lidhen me burimet e deklaruar, afektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme këstet e blerjes së pasurisë “Apartamentit me sipërfaqe 136,7 m²”.*
36. Lidhur me pagesën e këstit të fundit, në shumën 10.000 USD në vitin 2005, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për vitin 2005, në vlerën (-) 715.068 lekë. Sipas Komisionerit Publik, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare të vitit 2005 të shumës 600.000 lekë, të kthyer nga shoqëria ndërtuese, bie ndesh me aktet e administruara në dosje dhe nuk duhet konsideruar në analizën financiare të vitit 2005.
37. Në referim të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues vëren se ai kundërshton qëndrimin përfundimtar të Komisionit për këtë pasuri që bie në kundërshtim me vetë konkluzionet e tij për ligjshmërinë e burimeve që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. Konkretisht, Komisioneri Publik kundërshton faktin se ndërsa Komisioni konkludon se huaja prej 2.000.000 lekësh e dhënë prej vëllezërve të subjektit të rivlerësimit, nuk provohet me burime të ligjshme, në përfundim ky konkluzion nuk e ka afektuar qëndrimin e Komisionit në drejtim të ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie. Ndërsa, për këstet e paguara për blerjen e pasurisë në vitin 2004, Komisioni konkludon se është provuar pjesërisht krijimi me burime të ligjshme i vlerës së kursimeve cash të deklaruar si burim krijimi për këstet e paguara këtë vit për blerjen e pasurisë, në qëndrimin përfundimtar për vlerësimin e kësaj pasurie, ky konkluzion nuk është konsideruar si relevant.
38. Lidhur me pasurinë apartament në Tiranë, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratat periodike vjetore të pasurisë të viteve 2003 dhe 2004, ka deklaruar si burim për blerjen e kësaj pasuri huanë prej 2.000.000 lekësh, të dhënë nga vëllezërit. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision, bashkë me deklaratën *vetting*, deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.8.2019, me të cilën vëllezërit M. dhe I. B. kanë deklaruar se: *“Në vitin 2002 i kemi dhënë hua motrës sonë, shtetases Ardiana Bera,*

shumën prej 2.000.000 lekësh, shumë të cilën e kemi sjellë dhe dërguar me persona të ndryshëm te familja jonë në Krujë. Burimi i krijimit të kësaj shume janë kursimet nga të ardhurat e emigracionit në shtetin anglez [...]”. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Me gjithë kërkimet e bëra nga vëllezërit e mi, nuk është bërë e mundur gjetja e dokumenteve (listëpagesa) në shtetin anglez për periudhën 1998 – 2002, për shkak të kalimit të një afati të gjatë kohor[...]”.*

39. Komisioni, pasi ka analizuar pretendimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti gjatë hetimit lidhur me këtë hua, ka konkluduar se, edhe pas kalimit të rezultateve të hetimit, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues dhe të dokumentojë pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e vëllezërve të saj për dhënien e shumës prej 2.000.000 lekësh në mars të vitit 2002. Informacioni i plotë, i shoqëruar me dokumentacion ligjor provues në formën e kërkuar nga ligji, për pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e huadhënësve fillon pas datës së deklaruar si dhënie e huasë. Për këto arsye, Komisioni nuk e ka përfshirë këtë hua në analizën financiare për periudhën shtator 1991 – 31 dhjetor 2003, për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* të deklaruar që ka shërbyer për pagesën e këstit të apartamentit. Komisioni ka konkluduar lidhur me këtë analizë se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë likuiditetin e deklaruar për periudhën shtator 1991 – 31 dhjetor 2003, duke rezultuar me balancë negative për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në fund të vitit 2003, në vlerën negative prej (-) 1.669.152 lekësh, vlerë së cilës i ka qëndruar dhe Komisioneri Publik në konkluzionet përfundimtare në Kolegj.
40. Në parashtrimet e paraqitura, si dhe në seancat gjyqësore publike të zhvilluara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik për këtë pasuri, duke argumentuar se Komisioneri ka interpretuar jo drejt analizën e burimit të krijimit të pasurisë apartament në pronësi të subjektit, pasi në thelb huaja e marrë prej vëllezërve nuk ka shërbyer si burim, pasi ajo është kthyer në vijim dhe një pjesë është dhuruar prej vëllezërve me rastin e lindjes së vajzës së subjektit në vitin 2006. Për sa i përket provueshmërisë së të ardhurave të vëllezërve në emigracion, si dhe ligjshmërisë së tyre, subjekti i rivlerësimit vlerëson se duhet të merren në konsideratë disa rrethana, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sikurse janë: (i) koha e hershme e krijimit të tyre; (ii) mungesa e detyrimit të kohës për të ruajtur dokumentacion provues; (iii) qëllimi i vëllezërve në atë kohë, që ishte realizimi i të ardhurave dhe jo verifikimi i ligjshmërisë së tyre; (iv) pamundësia e punëdhënësit për të ruajtur dokumentacion; si dhe (v) afati maksimal ligjor për ruajtjen e dokumentacionit fiskal. Për më tepër, sipas subjektit të rivlerësimit, është fakt i pakontestueshëm që vëllezërit kanë qenë emigrantë ekonomikë prej vitesh, dhe kanë krijuar të ardhura përgjatë qëndrimit të tyre në shtetin e huaj.
41. Lidhur me sa ka parashtruar më sipër subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, *së pari*, konstaton se nuk qëndrojnë pretendimet se huaja e marrë nga vëllezërit nuk ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si gjatë procesit të rivlerësimit, ashtu dhe në deklaratimet periodike vjetore, rezulton se subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit huanë e dhënë nga vëllezërit. Konkretisht, në deklaratën e

pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një nga burimet *kursimet familjare, me ndihmën e familjarëve të subjektit (të deklaruar në vite)*, ndërsa në rubrikën e të dhënave konfidenciale të kësaj deklarate ka sqaruar se *ka marrë hua pa kontratë, pa afat dhe pa interes, shumën prej 2.000.000 lekësh tek vëllezërit [...], për nevojat e blerjes së banesës*. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për apartamentin huamarrjen, ndërsa në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka deklaruar detyrim ndaj *M. dhe I. B. refugjatë ekonomikë në Angli, në vlerën 2.000.000 lekë, për blerjen e banesës me kontratë sipërmarrjeje datë 16.03.2002*. Ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën e detyrimeve ndaj të tretëve: “*Detyrim ndaj kontratës së sipërmarrjes për blerje apartamenti, datë 16.03.2002, me vlerë 6 milionë lekë: 1. Në vitin 2003 paguar 2 milionë lekë; 2. Në vitin 2004 paguar 3 milionë lekë nga kursimet cash, plus huamarrja nga vëllezërit e deklaruar në vitin 2003*”.

42. Trupi gjykues vëren se, në rastet e deklarimit si burim krijimi të pasurive të tyre të ardhurat nga emigracioni, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin që të paraqesin të gjitha dokumentet që provojnë burimin dhe justifikojnë ligjshmërinë e tij. Në këtë kuptim, në përputhje me parashikimin kushtetues të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, verifikimi i ligjshmërisë së këtyre të ardhurave përmbushet vetëm në saje të administrimit të dokumentacionit që provon ekzistencën e: (i) një burimi real të ardhurash; dhe (ii) vlerën e të ardhurave të krijuara nga personi deklarues, dhe jo të mundësisë objektive, potenciale, për të krijuar të ardhura gjatë periudhës së deklaruar. E parë në këndvështrim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive – subjekti i rivlerësimit është i ngarkuar me detyrimin për të justifikuar mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur për dhënien e kësaj huaje, që i ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, me aktet që ka paraqitur si në Komision, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, pavarësisht se provon qëndrimin e vëllezërve si emigrantë ekonomikë, nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor dhe të dokumentojë pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e tyre për periudhën që i përket dhënies së huasë, pasi informacioni i sjellë, i shoqëruar me dokumentacion ligjor për burimin e të ardhurave, fillonte vetëm pas dhënies së kësaj huaje, në mars të vitit 2002. Për këto arsye, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar mundësinë financiare të huadhënësve për të dhënë huanë në vlerën 2.000.000 lekë, kjo rrethanë sjell si pasojë që huaja e marrë nga vëllezërit të mos konsiderohet si burim i ligjshëm për shlyerjen e pagesave të kësteve të apartamentit, duke ndikuar në ligjshmërinë e burimeve të deklaruar në deklaratën *vetting* nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie.
43. Për sa u përket kursimeve *cash* në fund të vitit 2003, në vlerën 5.000.000 lekë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për dy këstet e paguara për blerjen e apartamentit në vitin 2004, Komisioneri Publik në ankim, dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në parashtrime e konkluzionet përfundimtare, pretendojnë se meqenëse nuk u provua krijimi me burime të ligjshme i një pjese të kursimeve *cash* të deklaruar, ky fakt afekton në mënyrë të

drejtpërdrejtë mundësinë e subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme këstet e blerjes së apartamentit në vitin 2004. Edhe në këtë rast, Komisioneri Publik u referohet konkluzioneve të Komisionit, i cili ka konkluduar se likuiditeti që duhet të merret në konsideratë në analizën financiare të vitit 2004 është vetëm vlera e gjendjes *cash* e provuar lidhur me ligjshmërinë, konkluzion i mbështetur në parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencën e Kolegjit.

44. Lidhur me këtë shkak ankimi, nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003, në rubrikën “Likuiditete”: *Gjendje cash në banesë në shumën 5.000.000 lekë. Burimi: Kursime familjare nga paga ime dhe bashkëshortit*. Ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* gjatë vitit 2004 në shumën 3.000.000 lekë për pagesën e detyrimit të shoqërisë ndërtimore, duke sqaruar se *në vitin 2004 paguar 3 milionë lekë nga kursimet cash, plus huamarrja nga vëllezërit e deklaruar në vitin 2003*.
45. Komisioni, pasi ka kryer analizën e gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti, ka vlerësuar se burimi i deklaruar nga subjekti për shlyerjen e shumës 3.000.000 lekë në vitin 2004 referon në pakësimin e gjendjeve *cash* të deklaruara në fund të vitit 2003, prej 5.000.000 lekësh, për të cilat u arrit të dokumentohej nga subjekti ligjshmëria e burimit të tyre vetëm për vlerën 3.330.848 lekë (5.000.000 lekë – 1.669.152 lekë)⁴. Në këto kushte, Komisioni ka marrë në konsideratë në analizën financiare përfundimtare vetëm vlerën 3.330.848 lekë, e provuar për sa i përket ligjshmërisë së saj, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit për pagesën e shumës 3.000.000 lekë ndaj shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara në vitin 2004. Analiza financiare përfundimtare e vitit 2004 e kryer nga Komisioni rezulton me diferencë pozitive prej (+) 467.292 lekësh.
46. Trupi gjykues vëren se, dhe në rastin e gjendjes *cash* prej 5.000.000 lekësh të deklaruar në fund të vitit 2003, që ka shërbyer si burim për shlyerjen e kësteve të blerjes së apartamentit në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pjesë e kësaj shume *cash* ka qenë dhe huaja e dhënë nga vëllezërit në vitin 2002. Në vijim të arsytimit të mësipërm, lidhur me ligjshmërinë e huasë së dhënë nga vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se edhe në rastin e gjendjes *cash*, në kushtet kur huaja nuk konsiderohet e krijuar me burime të ligjshme, ky fakt prek/afekton dhe ligjshmërinë e gjendjes *cash*, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim për pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit. Ky konkluzion, lidhur me ligjshmërinë e burimit të deklaruar, arrihet pavarësisht faktit që sipas analizës financiare të vitit 2004, të kryer në Komision, duke konsideruar në analizë vetëm vlerën e gjendjes *cash* të provuar si e krijuar me burime të ligjshme, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të vitit 2004.
47. Në përfundim, në analizë të të gjitha deklaramëve të subjektit të rivlerësimit, akteve të fashikullit të Komisionit, si dhe akteve të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj,

⁴ Në kursimet *cash* prej 5.000.000 lekësh të deklaruara deri në fund të vitit 2003, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë huanë prej 2.000.000 lekësh të dhënë nga vëllezërit.

rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mbulimin me burime financiare të ligjshme të huasë së dhënë nga vëllezërit në shumën prej 2.000.000 lekësh, deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike të pasurisë të viteve 2003 dhe 2004. Subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ në Komision, edhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk arriti të provojë vlerën e të ardhurave të realizuara nga puna në emigracion nga personat e tjerë të lidhur, vëllezërit, përpara dhënies së huasë. Si rezultat, ashtu si ka konstatuar dhe Komisioneri Publik në ankim dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në parashtime e konkluzione përfundimtare, nuk u provua mbulimi plotësisht me burime të ligjshme i gjendjes *cash* në vlerën prej 5.000.000 lekësh, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si një prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie, pjesë e të cilës ka qenë dhe huaja, duke rezultuar për periudhën 1991- 2003 me një balancë negative në vlerën prej (-) 1.669.152 lekësh për krijimin e gjendjes *cash*.

48. Për sa i përket pagesës prej 10.000 USD, të kryer nga subjekti në vitin 2005, për apartamentin në fjalë, Komisioneri Publik ankimon se, edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit për vitin 2005, në vlerën negative prej (-) 715.068 lekësh. Komisioneri Publik këtë pamjaftueshmëri e lidh me shumën 600.000 lekë, të cilën subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se i është kthyer nga shoqëria e ndërtimit për shkak të punimeve shtesë që ka kryer vetë.
49. Sipas akteve rezulton se Komisioni, në analizën paraprake në raportin e rezultateve hetimore, ka konkluduar për vitin 2005 një balancë negative prej (-) 715.068 lekësh. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj rezultateve hetimore, ka pretenduar se në analizën e këtij viti duhet të futej dhe kthimi i shumës 600.000 lekë nga shitësi, shoqëria “{***} “SHPK, për punime shtesë të kryera nga vetë subjekti në vitin 2003, për apartamentin. Për rrjedhojë, sipas subjektit të rivlerësimit, analiza financiare për këtë vit rezulton me një diferencë më të vogël prej (-) 115.068 lekësh. Komisioni, në vendim, në përfundim, ka pranuar pretendimin e subjektit dhe e ka konsideruar vlerën 600.000 lekë si të kthyer, duke konkluduar në analizën e vitit me një balancë negative në vlerën (-) 115.068 lekë. Komisioni ka arritur në këtë qëndrim pasi: *“Në analizë të deklarimit periodik të vitit 2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kthimin e vlerës 600.000 lekë nga shoqëria ndërtuese. Trupi gjykues, në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, i ka njohur vlerën e provës deklaratës së pasurisë së vitit 2005, si e dhënë që vërteton pretendimet e subjektit në proces dhe duke e çmuar atë me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli. Në arsyetimin sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se vlera 600.000 lekë, e shpenzuar prej vetë subjektit e bashkëshortit në datën 14.05.2003 dhe e përfshirë në analizën financiare të subjektit deri në vitin 2003 sipas tabelës nr. 5 në këtë vendim, duhet të përfshihet në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur si vlerë e kthyer nga shoqëria ndërtuese në vitin 2005”*.
50. Komisioneri Publik në ankim dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në parashtime e konkluzionet përfundimtare ndajnë qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe pretendojnë se shuma 600.000 lekë nuk duhet të përfshihet në analizën financiare të vitit 2005, pasi bie ndesh me aktet e administruara në dosje sipas së cilave rezulton se: (i) në deklaratën *vetting*, në

deklaratat periodike vjetore dhe gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vlerë për blerjen e apartamentit shumën 6.000.000 lekë; (ii) në kontratën e shitblerjes, datë 23.09.2011, palët kanë rënë dakord që çmimi i shitblerjes së pasurisë është 6.000.000 lekë; (iii) mandatpagesat e depozituara për këtë pasuri janë në total në vlerën 6.000.000 lekë; (iv) në shkresën e shoqërisë “{***}” ShPK konfirmohet dhe njëherë se, pavarësisht kontratës së sipërmarrjes që ka vlerën 54.600 USD, janë kryer dy pagesa në dollarë (USD) dhe dy pagesa në lekë, që në total janë në vlerën 6.000.000 lekë. Gjithashtu, shoqëria ka informuar se, meqenëse kursi i dollarit gjatë këtyre viteve ka pësuar rënie, duke vlerësuar dhe punimet e kryera nga vetë klientja, detyrimi përfundimtar ndaj shoqërisë “{***}” ShPK pasqyruar dhe në kontratën e shitjes, datë 23.09.2011, është 6.000.000 lekë, i cili është shlyer totalisht nga klientja Ardiana Bera; (v) nuk është administruar asnjë dokument i kohës, që të provojë kthimin e kësaj shume të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës.

51. Subjekti i rivlerësimit, në procesin e zhvilluar në Kolegj, kundërshtoi argumentet e Komisionerit Publik, duke parashtruar se e ka deklaruar saktësisht faktin e kthimit të shumës 600.000 lekë në deklaratën e interesave periodike për vitin 2005 dhe se vetë shoqëria “{***}” ShPK ka deklaruar përpara Komisionit se [...] *meqenëse kursi i dollarit gjatë këtyre viteve ka pësuar rënie, duke vlerësuar dhe punimet e kryera nga vetë klientja, detyrimi përfundimtar ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, pasqyruar dhe në kontratën e shitjes, datë 23.09.2011, është 6.000.000 lekë, e cila është shlyer totalisht.* Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e paraqitura në Kolegj ka argumentuar se lidhur me mungesën e dokumentacionit të kohës për kthimin e kësaj shume, referuar legjislacionit në fuqi në kohën e kthimit, pra, në vitin 2005, nuk ka pasur detyrim ligjor për të dokumentuar me ndonjë akt me shkrim kthimin e kësaj shume, në mungesë të një parashikimi të posaçëm në dispozitat e Kodit Civil dhe të parimit ligjor të lirisë kontraktuale. Subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj, në seancën e datës 09.04.2025, një vërtetim të shoqërisë “{***}” ShPK, të datës 08.04.2025, bashkëlidhur të cilit ndodhen disa mandatpagesa, midis të cilave dhe një mandatpagesë e datës 15.12.2005, me vlerë 600.000 lekë, me përshkrimin *pagesa për punime të kryera nga klienti sipas preventivit të datës 14.05.2003.*
52. Lidhur me punimet shtesë të deklaruara të kryera nga vetë subjekti në vitin 2003, me vlerë 600.000 lekë, nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, rezulton si vijon.

52.1. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar tek seksioni detyrimet financiare *detyrimi ndaj kontratës së sipërmarrjes [...] paguar me kursimet nga paga dhe kursimet e mbartura minus 600.000 lekë. Vlera e shlyer: 10.000 USD.*

52.2. Në procesverbalin e ILDKPKI-së, të datës 15.01.2015, sjellë nga ILDKPKI-ja në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 17.03.2021, i pyetur lidhur me diferencat e çmimeve të apartamentit në kontratën e sipërmarrjes datë 16.03.2002 prej 54.600 USD dhe kontratës së shitjes 23.09.2011 me vlerë 6.000.000 lekë, subjekti ka sqaruar se kjo diferencë lidhet me punimet e kryera nga vetë subjekti i rivlerësimit. Subjekti ka bashkëlidhur një vërtetim të thjeshtë të shoqërisë “{***}” ShPK, të datës 01.10.2014, e cila ka informuar për punime të kryera shtesë: “[...] *meqenëse kursi i dollarit gjatë këtyre viteve ka pësuar rënie,*

*duke vlerësuar dhe punimet e kryera nga vetë klientja, detyrimi përfundimtar ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, pasqyruar dhe në kontratën e shitjes, datë 23.9.2011, është 6.000.000 lekë [...]”.*

52.3. Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 6.10.2023, që i ka dërguar Komisionit shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK, nga kjo shoqëri janë dhënë sqarime njësoj si në shkresën e thjeshtë të datës 01.10.2014 (të cilën e ka dërguar bashkëlidhur), si dhe i është dërguar Komisionit bashkëlidhur dhe një preventiv punimesh i datës 14.05.2003 (me firmë e vulë të shoqërisë), me vlerë 600.000 lekë, me përshkrimin “Preventiv punimesh bërë nga vetë klienti, Kulla {***}, kati i {***} banim, apartamenti 136,7 m²” dhe shënim *kjo vlerë do t’i zbritet klientit A. Bera.*

52.4. Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 30.11.2023, i pyetur lidhur me diferencat e çmimeve në kontratën e sipërmarrjes me çmim 54.600 USD dhe kontratën e shitblerjes me çmim 6.000.000 lekë, ka sqaruar se mendon se vlerat janë të barabarta dhe se në rakordimet e palëve në 2011 me hartimin e kontratës së shitblerjes nuk ka pasur pretendime midis palëve për këstet e paguara. Po në këtë pyetësor, pasi është pyetur lidhur me shpenzimet e kryera, llojin dhe burimet e të ardhurave, subjekti ka sqaruar se vlera e punimeve shtesë ka qenë rreth 600.000 lekë e, me sa kujton, kjo shumë është zbritur nga vlera e apartamentit dhe është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2005.

53. Sipas akteve sa më sipër, trupi gjykues konstaton se si në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në procesverbalin e ILDKPKI-së, të datës 15.01.2015, në shpjegimet lidhur me diferencën e çmimeve në kontratën e sipërmarrjes prej 54.600 USD me kontratën e shitblerjes prej 6.000.000 lekësh, ashtu dhe në aktin/vërtetimin e shoqërisë “{***}” ShPK, të datës 01.10.2014 të sjellë në Komisioni, ngelet e paspecifikuar vlera e pretenduar nga subjekti për punimet shtesë. Subjekti i rivlerësimit e ka pretenduar kthimin e shumës lidhur me punimet bazuar dhe në deklarin që ka bërë në deklaratën periodike të vitit 2005, ndërkohë që nga përmbajtja e këtij deklarimi: *Paguar me kursimet nga paga dhe kursimet e mbartura minus 600.000 lekë*, nuk del e qartë se me çfarë veprimesh/pagesash është e lidhur vlera 600.000 lekë.

54. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision ka pretenduar se shuma 600.000 lekë lidhet me punime shtesë të kryera prej tij. Në shkresën e shoqërisë “{***}” SHPK, të datës 06.10.2023, drejtuar Komisionit, citohet: *Gjatë vitit 2003 klientja Ardiana Bera ka bërë punime nga ana e saj, sipas preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese*, por nuk referohet se shuma e këtij preventivi është zbritur nga vlera e apartamentit dhe i është kthyer klientes. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se preventivi i punimeve në vlerën 600.000 lekë, edhe pse mban datën 14.05.2003, nuk është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit as në përgjigje të pyetjeve nga ILDKPKI-ja, sipas procesverbalit të datës 15.01.2015 dhe as në dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës *vetting*, ku ka paraqitur vetëm vërtetimin e datës 01.10.2014, të shoqërisë “{***}” ShPK. Gjithashtu, konstatohet se edhe në këtë vërtetim të kësaj shoqërie, pavarësisht se evidentohet fakti se klienti ka kryer vetë punime, nuk përmendet/përshkruhet se këtij të fundit i është kthyer mbrapsht ndonjë vlerë e këtyre punimeve.

55. Për sa i përket çmimit të blerjes së apartamentit në kontratën e sipërmarrjes të datës 16.03.2002 prej 54.600 USD dhe çmimit sipas kontratës së shitblerjes të datës 23.09.2011 me vlerë 6.000.000 lekë, sipas mandatpagesave të kryera, dy në dollarë (USD) dhe dy në lekë, trupi gjykues vëren se nëse do të konvertoheshin të gjitha vlerat në lekë, sipas kurseve të datave të pagesave rezulton se janë paguar 6.041.300 lekë⁵, pra, afërsisht 6.000.000 lekë (+ 41.300 lekë), aq sa është vlera e konfirmuar e paguar nga palët në kontratën e shitblerjes dhe në deklaratimet që subjekti ka bërë lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit në deklaratën *vetting*, në deklaratat periodike vjetore, si dhe gjatë procesit në Komision. Edhe nëse do konvertoheshin vlerat në dollarë, rezulton se janë paguar 53.616 USD⁶, pra ~ 54.600 USD (- 984 USD) sa vlera në kontratën e sipërmarrjes, pra, nuk ka diferenca domethënëse midis dy çmimeve të përcaktuara në kontratat përkatëse dhe vlerave të paguara sipas mandatarkëtimeve. Edhe shoqëria “{***}” ShPK, në shkresën e datës 06.10.2023, dërguar Komisionit, shprehet se: “[...] meqenëse kursi i dollarit ndaj lekut gjatë këtyre viteve ka pësuar rënie, duke vlerësuar dhe punimet e kryera nga vetë klientja, detyrimi përfundimtar ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, pasqyruar dhe në kontratën e shitjes, datë 23.09.2011, është 6.000.000 lekë [...]”. Nga përmbajtja e kësaj shkrese rezulton se shoqëria ndërtuese kërkon të shpjegojë se me rënien e kursit të këmbimit nga dollarë në lekë, edhe në kushtet e punimeve të kryera nga vetë klienti (subjekti), këto diferenca në çmim duket se kanë kompensuar diferencat e kursit të këmbimit përgjatë viteve, duke paguar më pak në ekuivalentin në lekë.
56. Trupi gjykues konstaton se nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur një dokument që të provojë kthimin e vlerës 600.000 lekë nga shitësi në vitin 2005, ndërkohë që, sipas mandatpagesës së fundit në vitin 2005, rezulton e paguar ndaj shoqërisë ndërtuese vlera 10.000 USD, pa reflektuar zbritje të ndonjë shume konkrete. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një informacion të shoqërisë “{***}” ShPK, të datës 08.04.2025, të shoqëruar me disa mandatpagesa, midis së cilave dhe një mandatpagesë e datës 15.12.2005, me vlerë 600.000 lekë, me përshkrimin *pagesa për punime të kryera nga klienti sipas preventivit të datës 14.05.2003*. Lidhur me këtë akt, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare të paraqitura në Kolegj ka mbajtur qëndrimin se megjithëse i është kaluar barra e provës për pamjaftueshmërinë e konstatuar në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte provuese për të provuar kthimin e pretenduar të shumës 600.000 lekë. Mandatpagesa e depozituar nga subjekti i rivlerësimit rishtas gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj duhet marrë me rezervë, pasi vlerësohet si një akt i hartuar për efekt të këtij procesi dhe me qëllim për të justifikuar pamjaftueshmërinë e të ardhurave për vitin 2005.

⁵ Sipas mandatpagesës nr. {***}, datë 16.03.2002, me vlerë 14.300 USD, ekuivalenti 2.000.000 lekë; pagesat në vitin 2004, sipas mandatpagesave, në total 3.000.000 lekë; pagesa sipas mandatpagesës nr. {***}, datë 23.11.2005, 10.000 USD, e konvertuar me kursin e datës së pagesës, sipas Bankës Shqipërisë, prej 1 USD=104.13 lekë, është 1.041.300 lekë; në total gjithë pagesat janë në vlerën 6.041.300 lekë.

⁶ Sipas mandatpagesës nr. {***}, datë 16.03.2002, me vlerë 14.300 USD; mandatpagesës nr. {***}, datë 23.11.2005, prej 10.000 USD; mandatpagesave të vitit 2004, në datën 22.01.2004 prej 2.000.000 lekësh, e konvertuar me kursin e datës pagesës, sipas Bankës Shqipërisë, prej 1 USD=105.98 lekë është 18.871 USD, dhe në datën 15.12.2004 prej 1.000.000 lekësh, e konvertuar me kursin Bankës së Shqipërisë 1 USD=95.74 lekë, është 10.445 USD; në total të gjithë pagesat janë në vlerën 53.616 USD.

57. Në vlerësim të fakteve dhe të akteve si më sipër, si dhe të qëndrimeve të mbajtura nga palët gjatë procesit, trupi gjykues vëren se mandatpagesa që, sipas pretendimit të subjektit provon kthimin efektiv të shumës prej 600.000 lekësh në datën 15.12.2005, paraqitet për herë të parë në këtë fazë të gjykimit të çështjes së subjektit të rivlerësimit dhe nuk është paraqitur në Komision bashkë me mandatpagesat e tjera, dërguar nga shoqëria me informacionin e datës 06.10.2023 apo me preventivin e punimeve të datës 14.05.2003, i cili referohet në këtë mandatpagesë. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerësoi me rezervë këtë akt, si të hartuar për efekt të procesit të rivlerësimit, me qëllimin për të justifikuar pamjaftueshmërinë e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2005. Për rrjedhojë, në ndryshim nga Komisioni, trupi gjykues çmoi se shuma prej 600.000 lekësh nuk duhet të përfshihet në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për vitin 2005.
58. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet para seancës gjyqësore publike në Kolegj, si dhe në konkluzionet përfundimtare, ka paraqitur pretendimin për uljen e shpenzimeve të udhëtimit në analizën financiare të vitit 2005, sipas vërtetimit të agjencisë së udhëtimeve “{***}”, dorëzuar në Komision bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit standard, në 800 euro nga 1.200 euro, sipas përlllogaritjeve në analizën e Komisionit. Trupi gjykues e vlerësoi si të bazuar në akte këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit dhe, pas korrigjimit të shpenzimeve të udhëtimit, me 400 euro, pas kontrollit të analizës financiare, diferenca negative e vitit 2005 ulet me vlerën 49.064 lekë.
59. Në konkluzion, lidhur me pagesën e kështit të fundit për blerjen e apartamentit në shumën 10.000 USD, në vitin 2005, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkakut të ankimit lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 666.004⁷ lekë, pasi dështoi të provojë kthimin e shumës prej 600.000 lekësh nga shoqëria ndërtuese në vitin 2005.
60. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues e vlerëson të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mbulimin me burime të ligjshme të huasë të dhënë nga vëllezërit në shumën prej 2.000.000 lekësh, dhe të kursimeve *cash* të deklaruara si burim krijimi për këtë apartament, dhe se këto rrethana lidhur me burimet e deklaruara, afektojnë mbulimin tërësisht me burime të ligjshme të pagesave të kryera për blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 136,7 m²”. Për rrjedhojë, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- *Për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë në datën 15.02.2007*

61. Sipas Komisionerit Publik në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimet e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, pasi në deklaratën periodike të vitit 2007 nuk deklaroi burim krijimi, ndërsa në deklaratën *vetting* deklaroi si një nga

⁷ Komisioneri konkludoi për diferencën negative prej (-) 715.068 lekësh, në vijim të rezulttit të Komisionit, duke mos përfshirë si të kthyer vlerën prej 600.000 lekësh. Pasi është marrë në konsideratë pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e shpenzimeve të udhëtimit për këtë vit, duke u ulur me vlerën 49.064 lekë (715.068 lekë - 49.064 lekë = 666.004 lekë), diferenca negative korrigjohet me vlerën prej 49.064 lekësh dhe rezulton të jetë në vlerën (-) 666.004 lekë.

burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf”, që rezulton të jetë shitur disa muaj më vonë.

62. Sa i takon mbulimit me burime të ligjshme të depozitës në shumën 9.000 euro, që deklarohet si burim krijimi për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, Komisioneri Publik konstaton se në të gjitha variantet e analizës financiare të administruara në dosje, përfshirë dhe atë të depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj depozite. Komisioneri Publik thekson dhe faktin që kursimet *cash* të deklaruar nga subjekti në deklaratën e parë të pasurisë dhe që mbarten në vitet pasuese kanë rezultuar se nuk mbulohen plotësisht me burime të ligjshme.
63. Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat e mësipërme, lidhur me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë në datën 15.02.2007, duhen marrë në konsideratë nga Kolegji në një vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, duke iu shtuar diferencave negative të trajtuara në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.
64. Nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, në lidhje me këtë pasuri, rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Autoveturë e markës ‘Mercedes-Benz’, e tipit C220-CDI, me ngjyrë gri, viti prodhimit 1998, me naftë; e blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2007. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi: nga kursimet familjare, nga pagat; nga të ardhurat e përfituara nga shitja e autoveturës ‘Volkswagen golf’, viti i prodhimit 1994 (e cila është blerë në shumë 300.000 lekë, me kontratën e datës 21.03.2005, me nr. {***} rep., nr. {***} kol. dhe është shitur në shumën 400.000 lekë me kontratën nr.{***} rep., nr.{***} kol., datë 07.11.2007), të deklaruar në vite. Bashkëlidhur kontrata dhe certifikatë e pronësisë së mjetit lëshuar më datë 20.05.2007”*. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Me kontratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2007 është blerë autovetura markës ‘Benz Mercedes tipi C220’, ngjyrë gri, me targa {***}, viti prodhimit 1998. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%”*. Nuk deklarohet burimi i blerjes.
65. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor rezulton se personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit me kontratën e shitblerjes të datë 15.02.2007 kanë blerë automjetin tip “Mercedes-Benz, C220”, kundrejt çmimit 500.000 lekë, shumë e parapaguar e gjitha jashtë zyrës noteriale. Komisioni, nisur nga fakti që shpenzimet për blerjen dhe zhdoganimin e këtij mjeti nga shitësi kanë qenë në vlerën 653.470 lekë, në analizën financiare ka konsideruar këtë shumë si shumë e blerjes së mjetit nga subjekti dhe personi i lidhur.
66. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se: *“Në datën 06.12.2006 kam depozituar në Raiffeisen Bank shumën 9.000 euro, me burim kursime ndër vite. Nga kjo shumë e depozituar kam tërhequr 8.000 euro në datën 13.02.2007. Në datën 15.02.2007, kur kam blerë autoveturën e markës “Mercedes-Benz”, në shumën 500.000 lekë, këtë shumë e kam marrë nga shuma 8.000 euro, e tërhequr në Raiffeisen Bank më 13.02.2007”*.

67. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimet e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, pasi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 nuk deklaroi burim krijimi, ndërsa në deklaratën *vetting* deklaroi si një nga burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf”, që rezultoi të jetë shitur disa muaj më vonë, rezultoi se Komisioni, referuar kontratës së shitjes të datës 07.11.2007, ka konkluduar se të ardhurat nga shitja e këtij automjeti nuk mund të kenë shërbyer si burim për pagesën e çmimit të blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, në datën 15.02.2007. Për këtë arsye, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit për periudhën 01.01.2007 – 15.02.2007, lidhur me mundësinë e blerjes së automjetit. Trupi gjykues çmon se, në kushtet kur pasaktësia në deklaram nuk është kthyer në pengesë për ushtrimin e një kontrolli të plotë nga Komisioni, deklarimi i pasaktë i burimit të kësaj pasurie nuk sjell pasoja në kontrollin e kryer lidhur me të dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbejë më vete si shkak për vlerësimin e deklarimit të subjektit për këtë pasuri, si deklarim i pasaktë, në kuadër të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
68. Për sa i përket burimit tjetër për blerjen e automjetit, kursimeve nga pagat, si dhe likuiditetit 8.000 euro të tërhequr nga Raiffeisen Bank në datën 13.02.2007, nga aktet në dosje rezultoi se:
- 68.1. Në datën 13.2.2007 (dy ditë para blerjes së automjetit), subjekti ka tërhequr *cash* nga llogaria në Raiffeisen Bank shumën 8.000 euro, që rezultoi të jetë tërhequr nga likuiditeti në shumën 9.000 euro e depozituar *cash* në datën 06.12.2006.
- 68.2. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 llogarinë bankare në euro në Raiffeisen Bank, në shumën 9.000 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj, ndërsa lidhur me likuiditet *cash*, të disponuara në datën 31.12.2006, ka deklaruar, ndër të tjera, dhe shumën 9.000 euro si kursim *cash*, për të cilën gjatë hetimit administrativ ka pretenduar që kjo shumë nuk ka qenë *cash*, por bëhet fjalë për depozitën në Raiffeisen Bank.
- 68.3. Në procesverbalin e ILDKPKI-së, të datës 15.01.2015, në përgjigjen e pyetjes nr. 7, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Gjendja cash në datën 31.12.2006 janë shumat 3.000 euro dhe 1.2 milionë lekë me burim krijimi nga kursimet familjare, nga pagat, të deklaruara vit pas vitit. Shuma prej 9.000 euro është deklaruar gabim si cash, pasi kjo shumë është depozitë në Raiffeisen Bank”*.
69. Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e krijimit nga subjekti dhe personi i lidhur të depozitës prej 9.000 eurosh në datën 06.12.2006, duke përfshirë vetëm të ardhurat, shpenzimet, si dhe ngjarjet financiare të periudhës. Nga kjo analizë ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për depozitën në shumën 9.000 euro, krijuar në datën 06.12.2006, në llogarinë në emër të subjektit në Raiffeisen Bank dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 01.01.2006 – 06.12.2006, duke rezultuar me balancë negative prej (-) 187.083 lekësh, ndërsa sipas analizës financiare për gjithë vitin 2006 rezultoi pamundësia financiare në vlerën prej (-) 112.709 lekësh.

70. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ndër të tjera, ka deklaruar se: *lidhur me mundësinë e krijimit të depozitës në vitin 2006, e tërhequr në vitin 2007 dhe e përdorur si burim krijimi i pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, nga ana juaj është ndërtuar një analizë financiare, ku ka rezultuar me një diferencë negative në shumën (-) 187.083 lekë.* Sipas subjektit të rivlerësimit, depozita në shumën 9.000 euro, sipas pasqyrimit nga ana e Komisionit, nuk mund të krijohej vetëm për diferencën prej (-) 187.083 lekësh (e konvertuar me kursin e euros të vitit, ekuivalenti 1.510 euro), çka nënkupton që shuma për pjesën tjetër të depozitës duhet të rezultojë me burim të justifikuar. Nga konstatimi dhe verifikimi i dokumentacionit bankar, konfirmohet tërheqja bankare e depozitës dy ditë përpara blerjes së automjetit. Për këtë arsye, subjekti shprehet që kjo analizë financiare nuk ka kuptim, për sa kohë që në analizën financiare të kryer për depozitën, rezulton se është e justifikuar 7.490 euro (9.000 euro – diferencën e pajustificuar 1.510 euro = 7.490 euro).
71. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi marrjen në konsideratë të llogarisë bankare të tërhequr në vitin 2007, e cila rezultoi e provuar për sa i përket ligjshmërisë së saj në vlerën 7.490 euro. Marrja në konsideratë e gjendjes në llogarinë bankare të tërhequr në vitin 2007 në analizën përfundimtare financiare të kryer, e provuar për sa i përket ligjshmërisë në vlerën prej 7.490 eurosh, është konsideruar nga Komisioni se provon burimin e ligjshëm për pagesën e automjetit dy ditë pas tërheqjes së depozitës.
72. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni sa i takon mbulimit me burime të ligjshme të depozitës në shumën 9.000 euro, që deklarohet si burim krijimi për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, pasi në të gjitha variantet e analizës financiare, si të Komisionit, ashtu dhe atë të depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, ka rezultuar mungesë e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj depozite. Komisioneri Publik vëren që dhe në analizën financiare të depozituar nga subjekti, ku përfshihen likuiditetet *cash* në fillim dhe në fund të vitit 2006, si dhe huaja e deklaruar e shlyer në shumën 1.000.000 lekë, ka rezultuar një diferencë negative në vlerën (-) 266.117 lekë. Nëse në këtë analizë do të përfshihej edhe shuma 9.000 euro, që subjekti e ka deklaruar si kursim *cash* në deklaratën periodike të vitit 2006, por gjatë hetimit ka deklaruar se këtë shumë nuk e ka disponuar *cash*, por në llogari bankare, atëherë diferenca negative do të ishte ndjeshëm më e lartë.
73. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nga konstatimi dhe verifikimi i dokumentacionit bankar konfirmohet tërheqja bankare e depozitës dy ditë përpara blerjes së automjetit. Për këtë arsye, qëndrimi i Komisionerit Publik, lidhur me këtë automjet, nuk ka kuptim, për sa kohë që referuar vetëm këtij momenti të analizës financiare rezulton që çmimi i blerjes justifikohet tërësisht me burime të ligjshme. Për më tepër, vetëm gjendja e likuiditeteve *cash* në fillim të vitit 2007 është e mjaftueshme për të justifikuar tërësisht me burime të ligjshme blerjen e këtij automjeti më datë 15.02.2007.
74. Lidhur me sa pretendon Komisioneri Publik në ankim, në raport me qëndrimin e Komisionit në vendim, trupi gjykues konstaton se pavarësisht se ai konkludon për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit nuk qartëson se sa është në vlerë

pamjaftueshmëria e pretenduar. Komisioneri Publik referon, si analizën financiare të Komisionit, ashtu dhe atë të paraqitur nga vetë subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, por pa dhënë një vlerë konkrete të pamjaftueshmërisë financiare të subjektit për blerjen e automjetit, si dhe nëse ka kontestime lidhur me vlerën 7.490 euro, për të cilën Komisioni ka konkluduar se subjekti ka pasur mundësi ta krijonte me burime financiare të ligjshme. Nga ankimi duket sikur Komisioneri Publik kërkon që të konsiderojë të gjithë shumën 9.000 euro si vlerë të paprovuar me burime të ligjshme dhe, për rrjedhojë, do të rriste bilancin negativ të periudhës, vetëm për shkak të faktit që subjekti e ka deklaruar në fillim si gjendje *cash* këtë shumë dhe më pas e ka korrigjuar, duke shpjeguar se në fakt ka qenë likuiditet në llogari bankare. Në kushtet kur Komisioneri Publik nuk ka dhënë në ankim detaje se cilën pjesë të analizës financiare për mundësitë e blerjes së automjetit konteston, si dhe vlerën e pretenduar të pamjaftueshmërisë financiare, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në seancën publike të datës 09.04.2025 u kërkuar sqarime nga relatorja e çështjes për këtë paqartësi. Në këtë seancë dhe në konkluzionet përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme ka saktësuar se për analizën financiare të vitit 2006 i qëndron, si Komisioni, të njëjtës vlerë të pamundësisë financiare prej (-) 112.709 lekësh.

75. Lidhur me pretendimet e Komisionerit Publik, për krijimin e depozitës në shumën 9.000 euro, trupi gjykues sjell në vëmendje se pavarësisht deklarimit të pasaktë nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2006 të shumës 9.000 euro si kursim *cash*, në këtë deklaratë ai ka deklaruar dhe llogarinë në Raiffeisen Bank në të njëjtën vlerë. Gjithashtu, sipas procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 15.01.2015, para fillimit të procesit të rivlerësimit, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë ka qenë në llogari bankare. Të gjitha këto rrethana, bazuar dhe në dokumentacionin bankar, e bëjnë të besueshëm për trupin gjykues deklarimin e subjektit të rivlerësimit se shuma 9.000 euro ka qenë e materializuar në llogari bankare. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se mbetet i bazuar qëndrimi dhe analiza financiare e kryer nga Komisioni për këtë pasuri.
76. Në konkluzion, për këtë pasuri, trupi gjykues, në një vlerësim harmonik të rrethanave, mori në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se krijimi i depozitës bankare në vitin 2006, në shumën prej 9.000 eurosh, ka shërbyer si burim për pagesën e automjetit në datën 15.02.2007, duke e konsideruar atë të krijuar me burime të ligjshme. Por pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues, ashtu si ka kërkuar dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare, vlerësoi se pamundësia financiare në vlerën (-) 112.709 lekë e konstatuar në analizën përfundimtare financiare të kryer nga Komisioni për gjithë vitin 2006, për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur, për mbulimin me të ardhura të ligjshme të shpenzimeve dhe krijimin e likuiditeteve, duhet të mbahet në konsideratë, duke iu shtuar diferencave negative të trajtuara në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

- Për llogarinë “Futura”, në emër të vajzës në Intesa Sanpaolo Bank

77. Komisioneri Publik, në ankimin drejtuar Kolegjit, parashtroi se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon plotësisht me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e krijuara në vitin 2007, përfshirë këtu edhe krijimin e llogarisë “Futura”, në lekë, në emër të vajzës në Intesa

Sanpaolo Bank. Sipas Komisionerit Publik, konstatohet, po ashtu, se për krijimin e llogarisë në emër të vajzës, në vitin 2007, janë deklaruar si burim shumat e dhëna nga vëllezërit në formë huaje/dhurimi, për të cilat nuk është provuar ligjshmëria e burimit të krijimit.

78. Komisioneri Publik, nga analizimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, lidhur me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2007, vëren se edhe duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit, se si burim krijimi kanë shërbyer kursimet *cash* të disponuara në fillim të vitit, të cilat më pas janë zëvendësuar përsëri me të ardhurat e vitit respektiv, nga analiza financiare vjetore e Komisionit, ka rezultuar se pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2007 nuk mbulohen plotësisht me burime të ligjshme. Sa i takon pamjaftueshmërisë së konstatuar për vitin 2007, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 nuk janë llogaritur sipas standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit, llogaritja e të cilave, sipas këtij standardi, e çon pamjaftueshmërinë e vitit 2007 në vlerën negative prej (-) 716.209 lekësh.
79. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet drejtuar Kolegjit, ka sqaruar se burimi i krijimit të kësaj depozite në qershor 2007 është pjesërisht shuma që subjekti u detyrohej vëllezërve për huanë e deklaruar të marrë prej tyre në vitin 2002, dhe që më pas iu bë dhuratë vajzës së saj. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga një analizë e pjesshme e periudhës 01.01.2007-18.06.2007, duke përfshirë kursimet *cash* të disponuara në fillim të vitit 2007, të përdorura dhe të zëvendësuar përsëri me të ardhurat e vitit respektiv, edhe me mospërfshirjen e dhuratës së vëllezërve prej 1.000.000 lekësh, sërish analiza financiare do të rezultonte pozitive. Për sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit parashtron se për llogaritja për këtë vit e shpenzimeve të jetesës, e kryer nga Komisioni, është e arsyeshme referuar rrethanave të subjektit. Ky qëndrim mbështetet në faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlera më të larta për këto shpenzime, dhe në këtë vit vajza e saj ka qenë foshnje, pra, nuk ka pasur kosto të larta jetese për t'i llogaritur ato për tre persona, dhe as nuk verifikohet ndonjë situatë që mund të sugjerojë për të kundërtën.
80. Nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, lidhur me këtë llogari bankare, rezulton se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Llogari "Futura" në lekë+plus interesa, në emër të vajzës K. H., pranë bankës Intesa Sanpaolo Albania, e hapur më 18.06.2007. Burimi i krijimit: Dhurata nga familjarët e subjektit dhe bashkëshortit të subjektit, miqtë me rastin e lindjes së fëmijës K. H. dhe në rastet e ditëlindjes së saj, nga kursimet familjare, nga pagat plus shpërblime nga puna, orë pune jashtë orarit. Vlera: 2.132.809,02 lekë. Pjesë takuese: 50% [...]. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën "Të dhëna konfidenciale", subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] kisha marrë hua shumë 2.000.000 lekë nga vëllezërit e mi [...]. Nga kjo hua e marrë, shuma 1.000.000 lekë, iu bë dhuratë vajzës time [...].*
81. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Detyrimi ndaj vëllezërve, i deklaruar në vitin 2003, në shumën 2.000.000 lekë, dhënë nga ana e tyre pa afat dhe interes, iu shlye vetëm për shumën 1.000.000 lekë. Shuma tjetër, prej 1.000.000 lekësh, iu bë dhuratë nga ana e tyre dhe prindërve me rastin e lindjes së vajzës, K. H. në janar 2006, familjes time [...].* Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, në rubrikën "Të dhëna

konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Kontratë për llogarinë e kursimeve “Fonde për të ardhmen e fëmijës”, shuma 1.000.000 lekë, në Bankën Intesa Sanpaolo (dhuratë e deklaruar në vitin 2006) [...].*

82. Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.02.2021, rezulton se kjo llogari bankare është hapur në datën 18.06.2007, me një depozitim *cash* nga subjekti i rivlerësimit të shumës 1.000.000 lekë, me përshkrimin *kursime nga puna*. Në vijim, kjo llogari është shtuar me depozitime *cash* dhe interesa bankare dhe gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016, në kohën e plotësimit të deklaratës *vetting*, rezulton në vlerën 2.132.809,02 lekë.
83. Komisioni, referuar burimit të deklaruar nga subjekti për hapjen e llogarisë në vitin 2007 – dhurimit nga vëllezërit e subjektit në vitin 2006 nga e pjesa e huasë, marrë në vitin 2002 prej 2.000.000 lekësh – ka konkluduar në vendim⁸ se: *nuk provohet burimi i ligjshëm për dhënien e huasë nga vëllezërit në vitin 2002 dhe, për rrjedhojë, kjo hua nuk mund të konsiderohet si burim krijimi edhe për depozitën në bankën Intesa Sanpaolo në emër të vajzës.*
84. Në vijim, Komisioni, në rezultatet e hetimit ka kryer analizën financiare për periudhën 16.02.2007⁹ – 18.06.2007, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe të personit të lidhur për krijimin e depozitës në emër të vajzës, në shumën 1.000.000 lekë, nga ku ka rezultuar një pamjaftueshmëri në vlerën (-) 704.358 lekë.
85. Nisur nga fakti që në deklaratën e interesave private për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” me kontratën e datës 15.2.2007 dhe krijimin e llogarisë “Futura”, në lekë, në emër të vajzës, hapur më 18.06.2007, Komisioni, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për kursimet *cash* të disponuara në fillim të vitit 2007, të përdorura dhe të zëvendësuara përsëri me të ardhurat e vitit respektiv, ka kryer analizën përfundimtare financiare gjithëpërfshirëse mbi gjithë pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera nga subjekti dhe personi i lidhur për gjithë vitin 2007, nga e cila ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për blerje pasurie, shtesë në likuiditet të deklaruar dhe kryerjen e shpenzimeve, duke rezultuar me një balancë negative përfundimtare për vitin 2007 në vlerën negative (-) 377.569¹⁰.
86. Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si gjatë procesit të zhvilluar në Komision, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, trupi gjykues vëren se si burim për krijimin e llogarisë bankare në emër të vajzës ka shërbyer dhe huaja e marrë nga vëllezërit, e cila pjesërisht në vlerën 1.000.000 lekë i është dhënë më pas vajzës së subjektit të rivlerësimit si

⁸ “14.17 Sipas arsyetimit në këtë vendim, lidhur me të ardhurat e marra hua nga vëllezërit e subjektit, për të cilat trupi gjykues ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues dhe të dokumentojë pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e vëllezërve të saj për dhënien e shumës 2.000.000 lekë në mars të vitit 2002, ato nuk mund të konsiderohen si burim krijimi për këtë depozitë në emër të vajzës së subjektit”.

⁹ Analiza financiare është kryer e pjesshme deri në momentin e hapjes së llogarisë më 18.06.2007, në Intesa Sanpaolo Bank, dhe si fillim periudhe është konsideruar data 16.02.2007, pas blerjes së automjetit, analizë që, sipas Komisionit, ka rezultuar me diferencë negative.

¹⁰ Në vendimin e Komisionit, në paragrafin 14.21, referohet një diferencë negative e ndryshme prej (-) 377.480 lekësh, por qëndron diferenca negative prej (-) 377.569 lekësh e detajuar sipas tabelës nr. 10, në vendim.

dhuratë. Trupi gjykues, në vijim të qëndrimit të mbajtur dhe në shkaqet e ankimit si më sipër, çmon se në kushtet kur nuk u arrit të provohej ligjshmëria e huasë së dhënë nga vëllezërit, kjo paligjshmëri afekton dhe burimin e krijimit të llogarisë në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit.

87. Lidhur me shkakun e ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik në ankim dhe të mbështetur nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në parashtrime e konkluzione përfundimtare, se shpenzimet e jetesës për vitin 2007 nuk janë llogaritur sipas standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit, trupi gjykues konstaton se Komisioneri Publik i ka përlllogaritur këto shpenzime në vlerën 707.904 lekë, bazuar në të dhënat e përcjella nga ILDKPKI-ja në institucionet e rivlerësimit. Këto të dhëna të pasqyruara në tabelën përmbledhëse të shpenzimeve të jetesës të hartuara nga ILDKPKI-ja janë bazuar në standardet e raportuara nga institucioni i vetëm i specializuar për statistikat, INSTAT dhe këto vlera janë përdorur nga ILDKPKI-ja nga viti 2004 e në vijim, në ushtrimin e funksioneve të saj kontrolluese ndaj subjekteve deklaruese, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Mënyra e vlerësimit të këtij zëri shpenzimesh, sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it për secilin vit të analizës financiare, përfshirë dhe vitin 2007, përbën një qëndrim të konsoliduar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit, jo vetëm si nevojë për ta mbështetur vendimmarrjen në të dhëna të standardizuara, dokumente dhe prova të besueshme, sipas parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por edhe në mbështetje të frymës që përshkon dispozitat kushtetuese dhe që reflektohet edhe në dispozitat e ligjit të sipërcituar se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve kryhet nga organet e rivlerësimit me ndihmën e organeve të tjera shtetërore të specializuara, pasi është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të¹¹.
88. Sa më sipër, për sa ka paraqitur në ankim Komisioneri Publik, trupi gjykues vlerëson se qëndron pretendimi i tij për konsiderimin e shpenzimeve për vitin 2007 në vlerën prej 707.904 lekësh, të përlllogaritura sipas standardit të ILDKPKI-së. Për pasojë, analiza financiare e vitit 2007, në ndryshim nga analiza financiare e kryer në Komision, rezulton me një balancë negative dhe mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 716.209 lekësh.
89. Në përfundim, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionerin Publik se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon plotësisht me burime të ligjshme financiare investimet, shpenzimet dhe kursimet e krijuara në vitin 2007, përfshirë këtu dhe krijimin e llogarisë “Futura”, në lekë, në emër të vajzës. Këtij konkluzioni i shtohet edhe konstatimi se për krijimin e kësaj llogarie në emër të vajzës në vitin 2007 është deklaruar si burim edhe shuma prej 1.000.000 lekësh e dhënë nga vëllezërit e subjektit të rivlerësimit në formë dhurimi, shumë e cila ka qenë pjesë e huasë prej 2.000.000 lekësh, për të cilën nuk u arrit të provohej ligjshmëria e burimit të krijimit edhe gjatë gjykimit në Kolegj. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mbulimin me burime të ligjshme të huasë së dhënë nga vëllezërit, edhe burimi i deklaruar për krijimin e llogarisë “Futura” nga kjo hua mbetet i paprovuar për sa i përket ligjshmërisë së tij.

¹¹ Shih vendimet e Kolegjit nr. 18/2022(JR), nr. 32/2023(JR) dhe nr. 53/2023(JR).

Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk i ka llogaritur shpenzimet e jetesës për vitin 2007, sipas standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit dhe, pas korrigjimit të tyre, diferenca negative për këtë vit rezulton të jetë në vlerën (-) 716.209 lekë.

90. Komisioni, në vendim, në përfundim për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka konkluduar se mungesa e likuiditeteve nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për vitin 2005 në vlerën prej (-) 115.068 lekësh, për vitin 2006 në vlerën prej (-) 112.709 lekësh dhe për vitin 2007 në vlerën prej (-) 337.489¹² lekësh, për gjithë periudhën e deklarimit, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera. Sipas vlerësimit të Komisionit, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, mospërputhjet e reflektuara në dokumentacionin ligjor të përfitimit të pasurisë apartament si pasaktësi në veprimin e ligjshëm që passjell disponimin e kësaj pasurie nga subjekti dhe pamundësia financiare për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në fund të vitit 2003, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur se subjekti i rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, ka arritur një nivel të besueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë.
91. Komisioneri Publik vlerëson se nuk qëndron ky arsyetim i Komisionit në vendim, pasi përveç sa ka trajtuar në ankim dhe vetë rezultati financiar negativ i konstatuar nga Komisioni për vitet 2003, 2005, 2006 dhe 2007, në vlerën rreth (-) 2.200.000 lekë¹³, tejkalon dhe nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji në raste të ngjashme.
92. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare parashtroi se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon plotësisht me burime të ligjshme, investimet, shpenzimet dhe kursimet e krijuara për vitet 2003, 2005, 2006 dhe 2007, për një diferencë negative në total rreth (-) 3.200.000 lekë¹⁴ dhe se edhe në konsideratë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për kthimin e vlerës 600.000 lekë në vitin 2005, vlera negative nuk justifikon zbatimin e masës së proporcionalitetit.
93. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për aplikimin e parimit të proporcionalitetit nga Komisioni, trupi gjykues vëren se dispozitat e parashikuara nga Kushtetuta, por edhe nga ligji nr. 84/2016, i referohen aplikimit të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit për zgjidhjen e çështjes në tërësi, duke synuar që në rastet objekt vlerësimi në kuadër të rivlerësimit të subjekteve të këtij ligji, masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara. Në rastin e procesit të rivlerësimit, aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe

¹² Sipas analizës financiare në tabelën nr.10, në vendim, diferenca e vitit 2007 është (-) 377.569 lekë.

¹³ Sipas Komisionit, për vitin 2003 në vlerën (-) 1.669.152 lekë për krijimin e gjendjes *cash*; për vitin 2005 në vlerën (-) 115.068 lekë; për vitin 2006 në vlerën (-) 112.709 lekë; si dhe për vitin 2007 në vlerën (-) 337.489 lekë [që është (-) 377.569 lekë, sipas sqarimit në poshtëshënimin 10 më sipër], për gjithë periudhën e deklarimit nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

¹⁴ Përkatesisht për vitin 2003 ka rezultuar pamjaftueshmëri në vlerën (-) 1.669.152 lekë, për vitin 2005 në vlerën (-) 715.068 lekë, për vitin 2006 në vlerën (-) 112.709 lekë, për vitin 2007 në vlerën (-) 716.209 lekë, në total (-) 3.213.138 lekë.

objektivitetit nga organet e rivlerësimit i çon këto organe drejt dhënies së një mase disiplinore, bazuar vetëm në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe duke vlerësuar që masa e dhënë të jetë në proporcion me shkeljet e konstatuara. Në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor”*, ndërsa në nenin 52, pika 1 e po këtij ligji, parashikohet se *Komisioni dhe Kolegji, në shqyrtimin e çështjes, udhëhiqen nga parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit.*

94. Nga analizimi i këtyre dispozitave dhe praktika e konsoliduar e Kolegjit¹⁵, rezulton se proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe ai nuk mund të merret si parim i shkëputur për të mbuluar pasaktësitë dhe pamjaftueshmëritë e subjekteve të rivlerësimit në deklarime. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, pas konkluzionit të Komisionit për rezultatet financiare negative në vite dhe pas kontrollit të pjesshëm të kësaj analize edhe në Kolegji, trupi gjykues vlerëson se rëndësia e shkeljeve të konstatuara është e tillë që nuk lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit, për shkak të pasaktësive në deklarim, si dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive apartament me sipërfaqe 136,7 m², në Tiranë, automjetit “Mercedes-Benz”, si dhe krijimin e llogarisë “Futura” në emër të vajzës, siç është argumentuar më sipër.
95. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon plotësisht me burime të ligjshme financiare krijimin e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe kursimet e krijuara deri në vitin 2003, si dhe për vitet 2005, 2006 dhe 2007, për një diferencë negative totale në vlerën (-) 3.164.074 lekë¹⁶, e cila, në ndryshim nga konkluzioni i Komisionit në vendimin e tij, pamundëson zbatimin në mënyrë objektive të parimit të proporcionalitetit nga ana e Kolegjit. Mungesa e burimeve financiare të ligjshme çon në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka bërë deklarim të pamjaftueshëm e, për pasojë, ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

- B.2. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

96. Komisioneri Publik, në ankimin drejtuar Kolegjit, konstaton se Komisioni, gjatë procedurave të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, çmoi dhe bëri pjesë të hetimit administrativ¹⁷, duke përcjellë gjetjet përkatëse në aktin “Rezultate të hetimit”, edhe vendimin

¹⁵ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 2/2020, datë 27.02.2020; nr. 20/2020, datë 08.09.2020; nr. 36/2020, datë 16.12.2020, nr. 24/2022.

¹⁶ Si total i diferencave negative të vitit 2003 prej (-) 1.669.152 lekësh, vitit 2005 prej (-) 666.004 lekësh, vitit 2006 prej (-) 112.709 lekësh dhe vitit 2007 prej (-) 716.209 lekësh.

¹⁷ Komisioni, referuar burimeve të hapura në media, ka konstatuar dy çështje të cilat kanë marrë vëmendjen e opinionit publik, referuar në linkun <https://shqiptarja.com/lajm/kush-eshte-gjyqtaja-ardiana-bera-qe-skandalizoi-nderkombetaret-me-vendimin-per-21-janarin-denoj-me-burg-nenen-qe-8-me-pare-lindi-djalin-psej-2-vitesh-ne-proces-vetingu>, dhe i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me to.

nr. {***}, datë 07.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues.

97. Në lidhje me vendimin nr. {***}, datë 07.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioni, referuar burimeve të hapura në media se Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë ka vendosur më 12.03.2024 për transferimin e kësaj çështjeje në SPAK, pasi Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi në nëntor të vitit 2023 se hetimet e papërfunduara kishin shkelur të drejtën e jetës së viktimave, duke mbajtur në konsideratë edhe vendimin nr. 11, datë 02.04.2008, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin thuhet se: *“Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore”*, ka arritur në përfundimin se për sa çështja është ende në gjykim, në kuptim të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të shtrihet vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë çështje.
98. Sipas Komisionerit Publik, përkundër sa arsyeton Komisioni, bazuar në argumentet që janë përdorur prej tij (Komisionit), nga burimet e hapura të informacionit rezulton se vendimi i referuar, marrë nga GjEDNJ-ja, edhe pse lidhet me të njëjtën ngjarje, ka të bëjë me një procedim të pezulluar e të ndarë, të ndryshëm nga ai që është objekt i gjykimit të konkluduar me vendimin nr. {***}, datë 07.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në referencë të shpjegimeve të paraqitura me shkrim nga ana e subjektit të rivlerësimit, pas dërgimit të aktit “Rezultate të hetimit”, nga ana e Komisionit, ky i fundit do të duhej t’i kishte marrë në vlerësim ato dhe të argumentonte një qëndrim, që lidhet me gjetjet përkatëse, duke çmuar dhe mbajtur në konsideratë njëkohësisht edhe jurisprudencën e Kolegjit¹⁸. Në të tilla rrethana, kjo çështje duhet të gjejë trajtim në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar nga ana e Kolegjit.
99. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në përgjigje të kërkesës së relatores së çështjes gjatë seancave në Kolegj, se cili aspekt i kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale duhet të mbahet në konsideratë nga trupi gjykues i Kolegjit, për të evidentuar mangësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare të paraqitura në Kolegj, ka mbajtur qëndrimin se mangësia në aspektin e njohurive ligjore për zbatimin e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, sipas jurisprudencës kushtetuese, vendimit nr. 50, datë 30.07.1999, të Gjykatës Kushtetuese, duket se afekton besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke pasur në konsideratë dhe faktin që çështja ka qenë publike. Neni 375 i Kodit të Procedurës Penale parashikon të drejtën e gjykatës, si organ që jep drejtësi, të kualifikojë saktë faktin kriminal për të cilin është ngritur një akuzë, duke e përcaktuar atë ligjërisht saktë, sipas vlerësimit të saj dhe analizës që ajo bën në përfundim të gjykimit të një çështjeje penale.
100. Trupi gjykues, në vijim të përfundimeve të arritura nga shqyrtimi i shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik për kriterin e pasurisë, çmoi që konkluzioni se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë është i mjaftueshëm për të konkluduar në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në këto kushte, bazuar në parimin e ekonomisë gjyqësore, trupi gjykues vendosi të mos e marrë në shqyrtim shkakun e ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik, në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive

¹⁸ Vendimit të Kolegjit (JR) nr. 9/2020, prg. 16.5 - 16.10.

profesionale, për sa kohë që çdo konkluzion lidhur me të nuk do të arrijë të ndryshojë vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

101. Përfundimisht, mbështetur në konkluzionet e mësipërme dhe në parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Për rrjedhojë, vendimi nr. 760, datë 26.04.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, nuk është i bazuar në prova dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 760, datë 26.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 20.05.2025, në Tiranë.

ANËTARE

ANËTARE

ANËTAR

Albana SHTYLLA

Natasha MULAJ

Sokol ÇOMO

RELATORE

KRYESUESE

Mimoza TASI

Rezarta SCHUETZ